

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në pozicionet “Specialist IT” dhe “Sekretare Mësimore”:

A. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Specialist IT” në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta së paku në nivelin “Master profesional”, në njërin prej fushave të Inxhinierisë Informatike, Inxhinierisë Elektronike, Inxhinierisë së Telekomunikacionit;
2. Të kenë eksperiencë pune në fusha të ngjashme.

B. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Sekretare Mësimore” në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta në nivelin “Master i shkencave” në njërin prej fushave të komunikimit, drejtësisë, shkencave sociale, administrimit ose diploma të ngjashme;
2. Të kenë eksperiencë pune në fusha të ngjashme.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **27.07.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.